VENDIM
Nr.374, datë 20.5.1996

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.528, DATË. 17.10.1994 "PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESAVE QË FINANCOHEN NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE"

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.528, datë 17.10.1994, në pikën 2 shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:

"Në raste të veçanta personat e pajisur me autorizime për strehim sipas listës nominale të miratuara nga Kryetari i Këshillit të Ministrave sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.530, datë 17.10.1994 "Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave", mund të lidhin kontratë të përkohshme të shitjes së apartamentit me Entin Kombëtar të Banesave që nga monenti i shpalljes së prokurimit të banesës.

Në këtë rast këto persona janë të detyruar të parapaguajnë një këst fillestar sa 20% të vleftës së apartamentit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave sipas kostos mesatare për atë vit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi